



Nr./Br. 570-2017

Në pajtim me nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 16 të Rregullës Zgjedhore Nr.9/2013 për Votim, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Qendrës së Votimit, dhe nenit 3 pragrafi 1 pika (a) dhe (b) të Rregullës Zgjedhore 02/2013 Krijimi, Konfirmimi dhe Kundërshtimi i Listës së Votuesve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjet e rregullt të mbajtur me 18.05.2017, nxjerr këtë:

## U D H Ë Z I M

### Për Komisionet Komunale të Zgjedhjeve dhe Këshillat e Vendvotimeve për Identifikimin e Votuesëve në Vendvotim për Zgjedhjet e Parakohëshme për Kuvendin e Kosovës

- I. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve udhëzon KKZ-të dhe KVV-të zgjedhore që merren me organizimin dhe implementimin e zgjedhjeve, që ditën e zgjedhjeve më 11 qershor 2017, të pranojnë dokumentet e identifikimit të votuesve në vendvotim, siç janë përcaktuar në nenin 90 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet Përgjithshme :
  - a. leternjoftim i vlefshëm;
  - b. pasaport valide;
  - c. dokument i vlefshëm i udhëtimit;
  - d. leje e vozitjes e vlefshëm e Kosovës;
  - e. kartela e vlefshme e PZHBV; ose
  - f. kartela e vlefshme e refugjatit
- II. Votuesi ditën e zgjedhjeve që posedon ndonjërin nga dokumentet e parapara në nenin 90 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme mund të votojë pavarësisht skadimit të afatit të dokumenteve të UNMIK-ut, por që i njëjti duhet të jetë i regjistruar në Listën e Votuesve.
- III. Ky Udhëzim është i obligueshëm për KKZ-të dhe KVV-të, në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- IV. Kontakti për informata shtesë apo sqarime shtesë lidhur me këtë udhëzim është :  
**Nr Tel : 0800 55 555**
- V. Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e nëshkrimit dhe iu dërgohet trupave zgjedhore menjëherë.

Prishtinë, 18.05.2017

Kryetare e Komisionit Qendror Zgjedhor

**Valdete Daka**

